



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 06 mars 2026
Nr. Ref.: AGJ 2982/26

AKTGJYKIM

në

rastin KI199/25

Parashtrues

Hysen Shehu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave në lëndën [C-III.-
12-1592] nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me
Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Hysen Shehu, me vendbanim në Komunën e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Teki Bokshi, avokat në Komunën e Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore të cilat janë duke u zhvilluar pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: DHPGJS), përkitazi me lëndën [C-III.-12-1592].

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave të cilat janë duke u zhvilluar pranë DHPGJS-së, me pretendimin se mosvendosja e lëndës [C-III.-12-1592] cenon të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me dispozitat e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 korrik 2025, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), përmes postës elektronike.
6. Më 18 korrik 2025, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin [GJR.KI199/25], e caktoi gjyqtarin Jeton Bytyqi, gjyqtar raportues, dhe me Vendimin [KSH.KI199/25], caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Enver Peci (anëtarë).
7. Më 23 korrik 2025, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 17 tetor 2025, Gjykata e njoftoi DHPGJS-në për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga kjo e fundit që ta informojë Gjykatën përkitazi me (i) numrin e lëndës para DHPGJS-së; (ii) kohën e regjistrimit të lëndës pranë DHPGJS-së; (iii) fazën në të cilën gjendet rasti i parashtruesit; si dhe (iv) veprimet e ndërmarra nga DHPGJS-ja përkitazi me rastin e parashtruesit të kërkesës.
9. Më 5 nëntor 2025, DHPGJS-ja i dorëzoi në Gjykatë informatat e kërkuara.
10. Më 17 nëntor 2025, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë informata shtesë lidhur me procedimin e rastit.
11. Më 26 shkurt 2026, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri konstatoi se (i) kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e pranueshme; dhe se

(ii) ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.

Përmbledhja e fakteve të rastit

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se objekti i kontestit gjyqësor pranë DHPGJS-së është e drejta e pronësisë së parashtruesit të kërkesës përkitazi me palujtshmërinë e evidentuar si ngastra kadastrale nr. [4885], me kulturë arë e klasit të V-të, në sipërfaqe prej 0.92.80 ha, e cila ndodhet në Zonën Kadastrale Gjakovë-jashtë qytetit (në tekstin e mëtejme: prona kontestuese), e cila fillimisht i përkiste babait të ndjerë të parashtruesit të kërkesës, H.A.Sh nga Gjakova.
13. Më 12 dhjetor 1964, përmes Kontratës [Leg.Nr.489/64], e ndjera Gj.Sh, gjyshja e parashtruesit të kërkesës, e kaloi pronën kontestuese te ish-Kombinati Bujqësor në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: ish-Kombinati Bujqësor), trashëgimtare juridike e së cilës është e paditura e tanishme KBI “Ereniku”. Në kohën e lidhjes së kësaj kontrate, parashtruesi i kërkesës ishte i mitur, në moshën 8 (tetë) vjeçare.
14. Më 25 shkurt 1987, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale) për vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën kontestuese kundër ish-Kombinatit Bujqësor, duke kërkuar që gjykata të konstatojë se ai është pronar i pronës kontestuese, me arsyetimin se babai i tij, i cili ishte pronar i pronës kontestuese, kishte vdekur para lindjes së tij, dhe se ai ka qenë fëmijë i mitur në kohën e kalimit të pronës kontestuese te ish-Kombinati Bujqësor. Ndërsa, gjyshja e tij, e ndjera Gj.Sh, kishte lidhur kontratë shitjeje me Ish-Kombinin Bujqësor pa pasur të drejtë pronësie, dhe se kjo e bënte kontratën absolutisht *nul* dhe të pavlefshme.
15. Më 8 shkurt 1989, Gjykata Komunale, nëpërmjet Aktgjykimit [Civ.nr.159/87], e refuzoi si të pathemeltë padinë e parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera duke arsyetuar se Ish-Kombinati Bujqësor e kishte pasur paluajtshmërinë në posedim dhe shfrytëzim të pandërprerë që nga koha e blerjes në vitin 1964 dhe konsiderohej poseduese e ndërgjegjshme, duke marrë parasysh edhe faktin se parashtruesi nuk i kishte paguar obligimet tatimore për këtë pronë.
16. Më 14 mars 1989, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë, me propozimin që Aktgjykimi i lartëkur i Gjykatës Komunale të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim.
17. Më 13 tetor 1989, Gjykata e Qarkut në Pejë, nëpërmjet Aktgjykimit [AC.nr.293/89], e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.
18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, duke kërkuar që aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta të ndryshohen, ashtu që të aprovohet kërkesëpadia e tij, ose që të prishen të dy aktgjykimet dhe çështja të kthehet në rigjykim.
19. Më 7 shkurt 1991, Gjykata Supreme e Kosovës, nëpërmjet Aktvendimit [Rev.nr.8/90], e prishi Aktgjykimin Gjykatës Komunale në Gjakovë dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe çështjen e ktheu në rigjykim në Gjykatën Komunale.
20. Më 19 korrik 1991, Gjykata Komunale, nëpërmjet Aktgjykimit [C.nr.221/91], vërtetoi se parashtruesi i kërkesës është pronar i patundshmërisë kontestuese dhe vërtetoi se kontrata e lidhur në mes të ndjerës Gj.Sh dhe ish-Kombinatit Bujqësor është pa efekt

juridik ndaj parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se nuk kishte prova që dëshmonte se Gj.Sh ishte trashëgimtare e djalit të saj, të ndjerit H.A.Sh.

21. Më 11 mars 1992, KBI "*Ereniku*" ushtroi ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur, duke kërkuar që të priset Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Komunale dhe lënda t'i kthehet të njëjtës në rivendosje.
22. Më 3 korrik 1992, Gjykata e Qarkut në Pejë, përmes Aktvendimit [Ac.nr.282/92], e prishi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Komunale dhe e ktheu të njëjtën në rivendosje.
23. Më 16 maj 2000, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Komunale që të vazhdojë procedura gjyqësore për rastin në fjalë.
24. Më 7 gusht 2000, Gjykata Komunale, nëpërmjet Aktvendimit [C.nr.1176/92], (i) e ndërpreu procedurën në këtë çështje juridike gjerë në përfundimin e procesit administrativ rreth regjistrimit të KBI "*Ereniku*"; dhe vendosi se (ii) procedura mund të vazhdojë pas përfundimit të procedurës administrative të lartshënuar dhe me iniciativën e palëve në procedurë.
25. Më 10 tetor 2000, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Komunale vazhdimin e procedurës së ndërprerë, meqë ishin plotësuar kushtet e përcaktuara në Aktvendimin e 7 gushtit 2000.
26. Më 23 dhjetor 2000, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Komunale vendosjen meritorë të çështjes.
27. Më 24 korrik 2012, Gjykata Komunale, përmes Aktvendimit [C.nr.247/2000], vendosi që (i) Gjykata Komunale në Gjakovë pushon së pasuri juridiksion në këtë çështje; dhe (ii) shkresat e lëndës ia dërgoi DHPGJS-së për procedim të mëtejshëm.
28. Më 30 tetor 2025, DHPGJS-ja, përmes Urdhrit [C-III.-12-1592], kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh të bëjë rregullimin e padisë dhe precizimin e qartë të kërkesëpadisë, duke dorëzuar gjithashtu çdo dokument mbështetës për pretendimet e ngritura.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon para Gjykatës se kohëzgjatja e procedurës në rastin e tij që është duke u zhvilluar pranë DHPGJS-së cenon të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Ai argumenton se kjo procedurë ka nisur që nga viti 1987 dhe ka zgjatur për gati katër (4) dekada pa një epilog përfundimtar, duke përbërë një vonesë të papranueshme prej gati gjysmë shekulli.
31. Në vijim, parashtruesi i kërkesës pretendon se i është cenuar e drejta në mbrojtjen e pronës, sipas nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Ai thekson se përvetësimi i pronës nga KBI "*Ereniku*" ishte një akt arbitrar dhe i paligjshëm, pasi u krye pa njoftimin e pronarëve legjitimë dhe mbi bazën e një transaksioni me një jo-pronar.

32. Pra, parashtruesi pretendon se shteti apo ndërmarrja shoqërore nuk mund të fitojnë pronësinë përmes institutit të mbajtjes (*usucapio*), pasi posedimi i tyre ka qenë i padërgjegjshëm dhe i parregullt. Ai mbështetet në parimin civil se askush nuk mund të transferojë më shumë të drejta sesa ka vetë, duke argumentuar se blerja nga një jo-pronar e bën kontratën absolutisht të pavlefshme.
33. Parashtruesi gjithashtu thekson se, sipas nenit 53 të Kushtetutës, Gjykata është e obliguar të interpretojë të drejtat e njeriut në harmoni me vendimet e GJEDNJ-së, duke cituar raste si [*Radomilja kundër Kroacisë*](#), nr. 37685/10 dhe 22768/12, Aktgjykim i 20 marsit 2018 dhe [*Jovanovic kundër Kroacisë*](#), nr. 59109/00, Vendim i 28 shkurt 2002, për të dëshmuar se posedimi i autoriteteve publike mbi pronën e fituar nga jo-pronari nuk gëzon mbrojtje ligjore.
34. Më tej, parashtruesi pretendon se, si pasojë e shkeljeve të të drejtave elementare njerëzore dhe dhimbjeve shpirtërore të shkaktuara nga vonesat dekadente, atij i takon kompensimi i dëmit jomaterial. Ai kërkon shumën prej dhjetëmijë (10,000.00) euro, duke arsyetuar se kjo kërkesë bazohet në mungesën e një ligji kombëtar për mbrojtje të të drejtave për shkak të shkeljes së të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.
35. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) ta deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm dhe nenit 46 (Mbrojtja e Pronës) të Kushtetutës; dhe (iii) që Republika e Kosovës t'ia kompensojë parashtruesit të kërkesës shumën prej dhjetëmijë (10.000,00) euro.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“[...]”

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. [...]”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

36. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

37. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

38. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me nenet: 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

39. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston kohëzgjatjen e procedurës përkitazi me lëndën [C-III.-12-1592] që është duke u zhvilluar pranë DHPGJS-së. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit. Në lidhje me afatin për paraqitjen e kërkesës, Gjykata, duke pasur parasysh natyrën e pretendimit kryesor të parashtruesit, gjegjësisht kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore pranë DHPGJS-së, thekson se në rrethana të tilla nuk kërkohet përmbushja e kriterit të përcaktuar me nenin 49 (Afatet) të Ligjit, përkatësisht kriteri për dorëzimin e kërkesës brenda afatit kohor prej katër (4) muajsh, pasi lënda është ende në zhvillim e sipër.

40. Përveç kriterëve të përcaktuara në Ligj, Gjykata shqyrton tutje nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

Rregulli 34
(Kriteret e pranueshmërisë)

*“(1) Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme, nëse:
(...)”*

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

41. Gjykata thkson se kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me paragrafin 1 të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës dhe se e njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara nëpërmjet paragrafit 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës. Për më tepër dhe në fund, Gjykata thekson se kërkesa nuk mund të shpallet e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër. Prandaj, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të vlerësohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

42. Gjykata fillimisht rikujton se rrethanat e rastit ndërlidhen me padinë e parashtuesit të kërkesës të dorëzuar më 25 shkurt 1987 në Gjykatën Komunale kundër ish-Kombinatit Bujqësor, duke kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën kontestuese. Parashtuesi i kërkesës pretendon se kjo pronë i takonte babait të tij të ndjerë dhe se tjetërsimi i saj në vitin 1964 nga gjyshja e tij, në kohën kur ai ishte i mitur, ishte absolutisht i pavlefshëm. Pas një numër vendimesh dhe kthimin e lëndës në rigjykim, Gjykata Komunale në korrik të vitit 1991 e kishte aprovuar kërkesëpadinë. Megjithatë, kjo çështje u rikthye sërish në rivendosje nga Gjykata e Qarkut në Pejë në vitin 1992. Megjithatë, Gjykata Komunale më 24 korrik 2012 konstatoi se ajo nuk ka juridiksion për të vendosur për këtë lëndë dhe të njëjtën e dërgoi në DHPGJS. Ndërsa, veprimet e radhës procedurale u ndërmorën vetëm në vitin 2025, përkatësisht më 30 tetor 2025, DHPGJS-ja lëshoi një urdhër për rregullimin e padisë nga ana e parashtuesit të kërkesës, duke konfirmuar se deri në atë datë, ende nuk ishte marrë një vendim meritë lidhur me rastin.
43. Lidhur me këtë, parashtuesi i kërkesës pretendon se, si rezultat i kohëzgjatjes së procedurave përkitazi me lëndën e tij, atij i është shkelur (i) e drejta për një gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe (ii) e drejta në mbrojtjen e pronës, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës.
44. Andaj, Gjykata në vazhdim do të trajtojë këtë pretendim të parashtuesit të kërkesës në bazë të parimeve të përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës së saj gjyqësore, por edhe asaj të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për vendim brenda një afati të arsyeshëm

45. Gjykata fillimisht rikujton se paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës përcakton: “Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme [...]”.
46. Ndërsa, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së përcakton se “Çdo person ka të drejtë që [...] të dëgjohet [...] brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë [...], e cila do të vendosë [...] në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij [...] civile [...]”.
47. Bazuar në dispozitat e lartcekura, e drejta për një vendim brenda një afati të arsyeshëm është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
48. Lidhur me këtë, Gjykata tashmë ka një praktikë relativisht të konsoliduar gjyqësore që përfshin por nuk kufizohet në rastet (i) [KI64/23](#), parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha*, Aktgjykim i 31 gushtit 2023; (ii) [KI06/21](#), parashtrues *Dragan Mihajlović*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022; (iii) [KI19/21](#), parashtrues *Sadik Pllana*, Aktgjykim i 18 korrikut 2022; dhe (iv) [KI142/23](#), parashtrues *Fadil Berisha*, Aktgjykim i 12 shkurtit 2025. Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata ka afirmuar parimet e vendosura nga GJENDJ-ja, përfshirë rastet (i) *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, nr. 9616/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (ii) *Poiss kundër Austrisë*, nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (iii) *Abdoella kundër Holandës*, nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992; (iv) *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë*, nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000; (v) *Mikulić kundër Kroacisë*, nr. 53176/99, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002; (vi) *Scordino kundër Italisë* (nr.1), [DhM] nr. 36813, Aktgjykim i 29 marsit 2006; (vii) *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000; (viii) *Sürmeli kundër Gjermanisë*, nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006; (ix) *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2006; (x) *Mishqjoni kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2010; dhe (xi) *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë*, nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019.
49. Bazuar në praktikën e lartcekur gjyqësore, rezulton se: (i) përlllogaritja e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore fillon nga momenti kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palës për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar; (ii) gjatë llogaritjes merret për bazë procedura në tërësinë e saj, përfshirë këtu edhe procedurat e apelimit dhe procedurën e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor përfundimtar; (iii) arsyeshmëria e zgjatjes së një procesi gjyqësor duhet të vlerësohet duke u bazuar në rrethanat përkatëse dhe veçoritë e secilit rast; dhe se (iv) shteti është i detyruar që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të tillë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilit për një vendim përfundimtar gjyqësor, në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile të tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastet e GJEDNJ-së: *Poiss kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 50; *Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 74; *Comingersoll kundër Portugalisë*, cituar më lart, paragrafi 24; dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 142; dhe rastet e Gjykatës [KI06/21](#), cituar më lart, paragrafët 50-75; [KI19/21](#), cituar më lart, paragrafi 82; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 47).
50. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore matet duke u bazuar në këto kritere kryesore: (i) kompleksiteti i rastit, (ii) sjellja e palës, (iii) sjellja e autoriteteve shtetërore dhe (iv) rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor (shih rastin e GJEDNJ-së: *Surmeli kundër Gjermanisë*, cituar më lart,

paragrafi 128; rastet e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 65; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 48), të cilat në mënyrë të përmbledhur do të elaborohen në vijim.

51. Përkitazi me (i) kompleksitetin e rastit, kjo mund të ndërlidhet me çështjet faktike dhe ligjore; me përfshirjen e disa palëve në procedurë; me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta; apo edhe me një numër më të madh të raporteve të ekspertëve që kërkohen. Thënë kështu, edhe në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendor mund të vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih në mënyrë të ngjashme rastet e Gjykatës: [KI64/23](#), cituar më lart, paragrafët 66-67; [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 49; dhe rastet e GJEDNJ-së: [Papachelas kundër Greqisë](#), nr. 31423/96, Aktgjykim i 25 marsit 1999; dhe [Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 210).
52. Përkitazi me (ii) sjelljen e palës në procedurë, nuk kërkohet nga pala bashkëpunim aktiv me autoritetet gjyqësore e as nuk mund të fajësohet pala për përdorimin e mjeteve juridike sipas legjislacionit në fuqi, megjithatë autoritetet shtetërore nuk mund të mbahen përgjegjëse nëse këto veprime ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës; nga pala kërkohet vetëm të jetë e vëmendshme në ndërmarrjen e hapave proceduralë dhe të mos përdorë taktika për ta shtyrë procedurën në favor të tij; dhe se, vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund të ndikojnë në përcaktimin nëse procedurat nuk kishin përfunduar brenda një afati të arsyeshëm kohor. Disa shembuj që kanë të bëjnë me sjelljen e palës janë: mungesa e vullnetit për të dorëzuar shkresat, e cila mund të ndikojë në ngadalësimin e procedurës; ndryshimi i shpeshtë i avokatit; përpjekjet për të arritur marrëveshje jashtëgjyqësore; nisja e procedurës përpara gjykatës që nuk ka juridiksion për çështjen; mungesa e kujdesit në ndërmarrjen e hapave proceduralë (shih rastet e GJEDNJ-së: [Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë](#), cituar më lart, paragrafi 68; dhe [Union Alemntaria Sanders S.A kundër Spanjës](#), nr. 11681/85, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 35). Sjellja e palës përbën një fakt objektiv që nuk mund t'i atribuohet autoriteteve shtetërore dhe duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit nëse procedura ishte kryer brenda një periudhe të arsyeshme kohore (shih rastet e Gjykatës: KI64/23, cituar më lart, paragrafi 68-70; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 50).
53. Sa i përket (iii) sjelljes së autoriteteve kompetente, shteti mban përgjegjësi për të gjitha autoritetet dhe jo vetëm për sistemin gjyqësor, por edhe për sjelljet e institucioneve publike; gjatë vlerësimit nëse procedura është kryer brenda një afati të arsyeshëm kohor, gjykata duhet ta vlerësojë procedurën në tërësi; përkundër që shteti mund të jetë përgjegjës për defekte të caktuara procedurale, megjithatë kjo nuk e përjashton mundësinë që të ketë vepruar në përputhje me detyrat e veta për ta shqyrtuar rastin në mënyrë të shpejtë; shkaktimi i vonesave nga ndërrimi i shpeshtë i gjyqtarëve nuk e shmang përgjegjësinë e shtetit për kryerjen e procedurave brenda afateve të arsyeshme kohore; mbingarkesa kronike e lëndëve nuk mund të shërbejë si arsyetim për tejzgjatjen e procedurave; dhe se gjykatat nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore te tjetra (shih rastet e Gjykatës: KI64/23, cituar më lart, paragrafi 71-73; [KI06/21](#), cituar më lart, para. 67; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 51).
54. Sa i përket (iv) rëndësisë së asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontest, ekzistojnë kategori të caktuara të rasteve të cilat, për nga natyra e tyre, duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Shembuj të këtyre kategorive të rasteve përfshijnë: rastet që ndërlidhen me statusin; rastet që ndërlidhen me kujdestarinë e fëmijëve; me raportin prind-fëmijë; me kujdesin e gjyshërve ndaj fëmijëve, kur këta të fundit kanë mbetur pa kujdesin e prindërve; përgjegjësinë e prindërve dhe të drejtat e kontaktit me fëmijët; rastet që ndërlidhen me kontestet nga marrëdhënia e punës; ankesa kundër largimit nga puna; suspendimi nga puna;

transferimi; rikthimi në punë; rastet që ndërlidhen me persona të cilët vuajnë nga “sëmundje të pashërueshme” dhe kanë “pritje të reduktuar të jetëgjatësisë”; rastet që lidhen me pretendimet për ushtrim të dhunës nga zyrtarët policorë; dhe rastet kur mund të rrezikohet e drejta e edukimit. Disa raste të tjera nuk kërkojnë vëmendje të shtuar, për shembull rastet që lidhen me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidente rrugore apo rastet që kanë të bëjnë me ndarjen e trashëgimisë ndërmjet trashëgimtarëve të personit të vdekur (shih rastet e Gjykatës: KI64/23, cituar më lart, paragrafi 74; [KI06/21](#), cituar më lart, paragrafi 67; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 52).

Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

Periudha që do të merret parasysh

55. Lidhur me këtë, Gjykata rithekson se, më 25 shkurt 1987, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë kundër ish-Kombinatit Bujqësor për vërtetimin e pronësisë mbi pronën kontestuese. Pas një numri vendimesh që nga viti 1989 deri në vitin 1992, procedura ishte ndërprerë dhe vetëm pas kërkesave të përsëritura të parashtruesit të bëra gjatë vitit 2000, Gjykata Komunale më 24 korrik 2012 vendosi se ajo nuk ka juridiksion përkitazi me këtë lëndë dhe e dërgoi të njëjtën në DHPGJS. Sipas informatave të dorëzuara nga DHPGJ, rasti në fjalë kishte një pezullim deri sa ishte vendosur lidhur me padinë statusore [SCC-08-0124] të KBI “Ereniku me AKP-në, por e cila lëndë ishte vendosur më 7 mars 2014. Megjithatë, rasti i parashtruesit të kërkesës mbeti i pazgjidhur deri më 5 nëntor 2025, kur DHPGJS-ja e njoftoi Gjykatën për statusin e lëndës.
56. Prandaj, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se rasti i parashtruesit të kërkesës është riaktivizuar pas vitit 2000, ka vazhduar të shqyrtohet edhe pas 15 qershorit 2008, kur Kushtetuta ka hyrë në fuqi, dhe nga 24 korriku 2012 pret të vendoset nga DHPGJS-ja, deri më 5 nëntor 2025, kur DHPGJS-ja e njoftoi Gjykatën për statusin e rastit, duke përfshirë periudhën prej më tepër se 13 (trembëdhjetë) vjet që nga koha kur lënda është në shqyrtim pranë DHPGJS-së. Rrjedhimisht, kjo është periudha që do të merret parasysh nga Gjykata për vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurës.
57. Gjykata, për të ardhur në përfundim nëse në rastin e parashtruesit të kërkesës, rasti i tij ishte trajtuar brenda afatit të arsyeshëm, në vijim do të vlerësojë: (i) kompleksitetin e rastit, (ii) sjelljen e palëve në procedurë, (iii) sjelljen e autoriteteve shtetërore, si dhe (iv) rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor.

(i) Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit

58. Për sa i përket ndërlikueshmërisë së çështjes, Gjykata, bazuar në shkresat e lëndës, vëren se në rastin konkret ka pasur procedura të ndërmjetme dhe ndryshime statusore të palës së paditur KBI “Ereniku”, si dhe procedura përkitazi me juridiksionin e Gjykatës Komunale në vitin 2012, të cilat kanë ndikuar në rrjedhën e procedurës civile. Për më tepër, Gjykata vlerëson se çështjet që ndërlidhen me vërtetimin e të drejtës së pronësisë dhe vlerësimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave të tjetërsimit për nga natyra mund të jenë komplekse. Ky kompleksitet shtohet për shkak të nevojës për administrimin e provave të vjetra dokumentare, historikut të regjistrimeve kadastrale dhe faktit që lënda ka kaluar nga gjyqësori i rregullt në juridiksionin e DHPGJS-së.
59. Megjithatë, Gjykata vlerëson se, pavarësisht ekzistimit të një niveli të caktuar kompleksiteti të fakteve dhe provave, çështja nuk ka natyrë të tillë që të justifikojë një procedurë me kohëzgjatje të tillë. Përkundrazi, sipas parimeve të vendosura në

praktikën e GJEDNJ-së, edhe kur ekziston një kompleksitet i caktuar i rastit, një kohëzgjatje e tillë e procedurës tejkalon kufijtë e një afati të arsyeshëm dhe tregon mungesë efikasiteti dhe parashikueshmërie ligjore në veprimtarinë e gjykatave.

(ii) Përkitazi me sjelljen e palës

60. Lidhur me sjelljen e palëve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ndërmori çdo veprim procedural që u kërkuar nga gjykatat e rregullta dhe legjislati në fuqi për zgjidhjen e lëndës së tij civile në kohë të arsyeshme dhe pa vonesa të tepruara. Gjykata rikujton se, padia në Gjykatën Komunale ishte parashtruar fillimisht më 25 shkurt 1987, dhe pas riaktivizimit të procedurës pas vitit 2000, parashtruesi kishte parashtruar kërkesa për vazhdimin e procesit gjyqësor, veprime këto që dëshmojnë interesin e vazhdueshëm të palës për zgjidhjen e kontestit.
61. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se vetëm në DHPGJS, rasti i parashtruesit është duke pritur zgjidhje për më tepër se trembëdhjetë (13) vjet, dhe vetëm pas kësaj periudhe kohore atij i'u kërkuar që të bëjë rregullimin e padisë dhe precizimin e qartë të kërkesëpadisë, duke dorëzuar gjithashtu çdo dokument mbështetës për pretendimet e ngritura. Gjatë kësaj periudhe, nuk rezulton që parashtruesi të ketë përdorur mjete procedurale me qëllim të zvarritjes së procesit apo të ketë neglizhuar detyrimet e tij si palë. Prandaj, vonesat eventuale, në rrethanat e rastit konkret, nuk mund t'i atribuohen parashtruesit të kërkesës.

(iii) Sjellja e autoriteteve kompetente

62. Gjykata, në vlerësimin e sjelljes së autoriteteve kompetente, thekson se institucionet gjyqësore kanë dështuar të marrin një vendim meritore për çështjen. Pas dërgimit të lëndës në DHPGJS në korrik të vitit 2012, veprimet e radhës procedurale u ndërmorën vetëm në vitin 2025, kur më 30 tetor 2025 u lëshua një urdhër nga ana e DHPGJS-së ndaj parashtruesit të kërkesës për rregullimin e padisë. Arsyetimet e mundshme administrative apo mbingarkesa e DHPGJS-së nuk mund të justifikojnë një periudhë kaq të gjatë që nuk janë ndërmarrë veprime procedurale për vendosjen e rastit.
63. Duke pasur parasysh të lartcekurat, Gjykata thekson se përgjegjësia për zvarritjen e lëndës i mvishet tërësisht autoriteteve gjyqësore. Mosveprimi i gjykatave të rregullta, veçanërisht dështimi i DHPGJS-së për ta proceduar lëndën për një kohë kaq të gjatë, dëshmojnë për një dështim në administrimin e drejtësisë. Prandaj, Gjykata vlerëson se autoritetet kompetente, përmes zvarritjes së vendimeve procedurale dhe pasivitetit institucional, kanë kontribuar në një tejzgjatje të procedurës, duke e lënë parashtruesin pa një zgjidhje meritore të rastit.

(iv) Përkitazi me rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor

64. Lidhur me këtë kriter, Gjykata ka sqaruar kategoritë e caktuara të rasteve të cilat për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Ndonëse kontestet pronësore jodomosdoshmërisht hyjnë në kategorinë e rasteve urgjente (siç janë ato familjare apo penale), Gjykata thekson se pasiguria juridike mbi pronën për një periudhë kaq të gjatë përbën një barrë të rëndë për parashtruesin.
65. Thënë këtë, Gjykata thekson se kohëzgjatja e trajtimit të çështjes në fjalë, ku nuk ka ende një vendim meritore, është e papranueshme dhe si e tillë është në kundërshtim të plotë me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim brenda një afati kohor të

arsyeshëm, ashtu siç garantohet nga paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së.

66. Si përfundim, Gjykata, marrë parasysh aplikimin kumulativ të kriterëve të lartcekura, konstaton se: (i) megjithëse rrethanat e rastit ndërlidhen me një kontest pronësor që kërkon administrim provash të vjetra, çështja nuk rezulton të jetë e një natyre aq të ndërlikuar sa të justifikojë një kohëzgjatje të tillë; (ii) parashtuesi i kërkesës nuk ka kontribuar në tejzgjatjen e procedurës, por përkundrazi ka treguar vigjilencë duke kërkuar vazhdimisht procedimin e lëndës; ndërsa (iii) DHPGJS-ja, as pas më tepër se trembëdhjetë (13) vjetësh, nuk e ka zgjidhur rastin e tij, duke e lënë çështjen në fazën fillestare të *"rregullimit të padisë"* edhe në vitin 2025.
67. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se në rrethanat e parashtuesit të kërkesës, autoritetet gjyqësore kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
68. Duke qene se Gjykata konstatoi shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë, kjo e fundit nuk e sheh të nevojshme të vlerësojë shkeljet e pretenduara të parashtuesit të kërkesës për nenet e tjera të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së.
69. Gjykata gjithashtu thekson se përfundimi i lartcekur ekskluzivisht ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurave sa i përket shqyrtimit të rastit të parashtuesit të kërkesës dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit të tij para gjykatave të rregullta.

Përkitazi me kërkesën për kompensim

70. Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës ka kërkuar edhe që Republika e Kosovës t'ia kompensojë parashtuesit të kërkesës shumën prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro *"në emër të dhimbjeve shpirtërore"*.
71. Lidhur me këtë, Gjykata ka ripërsëritur se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji të kompensimit për rastet në të cilat konstaton shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së si pasojë e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore (shih rastet: [KI19/21](#), cituar më lart, paragrafi 115; [KI06/21](#), cituar më lart, paragrafi 84; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 68).
72. Gjykata përsërit se në disa raste gjetja e shkeljes kushtetuese paraqet një lloj të *"shpërblimit të drejtë"*, sidomos kur parashtuesi ka mundur të pësojë një dëm jomaterial. Megjithatë, individët mund të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese. Në rastet kur vetëm konstatimi i shkeljes nuk mjafton dhe kompensimi monetar është i domosdoshëm, individët kanë të drejtë të përdorin mjetet juridike në dispozicion për realizimin e të drejtave të tyre, përfshirë kompensimin e dëmit material dhe jomaterial pranë gjykatave të rregullta (shih rastet e Gjykatës: [KI06/21](#), cituar më lart, paragrafi 85 dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 69).
73. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se, pas këtij Aktgjykimi, nëpërmjet të cilit konstatohet shkelja e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, DHPGJS-ja duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për ta përmbyllur çështjen juridike të parashtuesit të kërkesës me prioritet, dinamikë të shtuar dhe brenda një afati sa më të shpejtë kohor, konform gjetjeve të këtij Aktgjykimi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 26 shkurt 2026, njëzëri:

VENDOS

- I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor;
- III. TA URDHËROJË Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që jo më larg 1 shtator 2026, ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 të Rregullores së punës;
- IV. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
- V. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Jeton Bytyqi

Nexhmi Rexhepi